



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 15.02.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 12.02.2024, të parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik Quality Asphalt SH.P.K.; CAPITAL X FET SH.P.K.; N.N.SH. WORLD MEDIUM, lidhur me aktivitetin e prokurimit me “**Rregullimi i rrugëve fushore në zonat rurale**”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-5381-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-070 -521, nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim të Operatorit ekonomik: “Grup i Operatorëve Ekonomik Quality Asphalt SH.P.K.; CAPITAL X FET SH.P.K.; N.N.SH. WORLD MEDIUM. e dt.12.02.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Rregullimi i rrugëve fushore në zonat rurale**”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-5381-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-070 -521, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 07.02.2024, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 07.02.2024;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.

A r s y e t i m

Grup i Operatorëve Ekonomik Quality Asphalt SH.P.K.; CAPITAL X FET SH.P.K.; N.N.SH. WORLD MEDIUM, me dt.12.02.2024, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Rregullimi i rrugëve fushore në zonat rurale**”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-5381-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-070 -521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 15.02.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj lidhur me ing.hidro teknikës Astrit Salihu, se nuk është kërkuar në FDT që të ketë kontributet e paguara dhe ky nuk mund të jetë shkak për diskualifikim, nuk qëndron, sepse në kontratën e punës të cilën e keni lidhur me Astrit Salihu, në nenin 19 të kontratës thuhet se punëdhënsi obligohet që të bëjë pagesën e kontributeve të punësuarit, prandaj mospagesa e kontributeve si dhe mos figurimi i tij në listën e ATK-së, e vë në dyshim vërtetësinë e kësaj kontrate (e cila kërkohej si dëshmi në FDT);

Pretendimi juaj lidhur me eskavatorin Liebherr A904 HDSL, nuk qëndron, sepse pavarësisht asaj që ju jeni rekomanduar njëherë për kontratë , gjatë ri-vlerësimit, komisioni gjatë shqimit të katalogjeve ka vërejtur se eskavatori në fjalë nuk e kalon peshën prej 17 ton, me çka nuk plotëson kërkesën e Autoritetit kontraktues në FDT-ë;

Pretendimi juaj lidhur me ISO Certifikatat nuk qëndron, sepse kërkesa e Autoritetit kontraktues për këtë pikë është tek “Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale”, dhe nuk është kërkuar që secili anëtarët i grupit të dëshmoj se përmbush standardet përkatëse;

Pretendimi juaj lidhur me çmimet, nuk qëndron, sepse të gjithë Operatorët ekonomik që kanë ofertuar duke ju përfshirë edhe juve, kanë pasur laramani të çmimeve në pozicione;

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankese pranë OSHP-së . Ankesa prane OSHP-se duhet te dorzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

